



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 2 Prill 2021

Nr: 17

**VENDIM I NDËRMJETËM**  
**PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 8, NR. 9 TË**  
**PARAQITURA NË KQZ DATË 01.04.2021 DHE NR.10 TË PARAQITUR NË KQZ NË**  
**DATËN 02.04.2021**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Anëtar  
Elvis ÇEFA - Anëtar  
Ilijan RUSMALI - Anëtar  
Koli BELE - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 8, nr. 9, të paraqitura në KQZ në datën 01.04.2021 dhe nr. 10 të paraqitur në KQZ datë 02.04.2021.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

#### V Ë R E N:

**Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë**, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 8 regj, datë 01.04.2021.

**Subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike**, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 9 regj, datë 01.04.2021.

**Subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim**, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 10 regj, datë 02.04.2021.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 02.04.2021, me vendimet nr. 14, nr. 15 dhe 16 vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat ankimore të paraqitura në KQZ në datën 01.04.2021 dhe një kërkesë ankimore të paraqitur në KQZ datë 02.04.2021. Relatorët e kërkesave ankimore përkatësisht z. Koli Bele, z. Elvin Lako dhe z. Ledio Braho konstatuan se, të tre kërkesat ankimore kanë të njëjtin objekt ankimi: Ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Në zbatim të nenit 19 pika 1 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, përcaktohet se, *KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim.....*

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave ankimore nr. 8, dhe nr. 9 të paraqitura në KQZ datë 01.04.2021 dhe kërkesën ankimore nr. 10 të paraqitur në KQZ datë 02.04.2021 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 8, datë 01.04.2021 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimimeve se kërkesat ankimore nr. 9, datë 01.04.2021 dhe nr. 10, datë 02.04.2021, atëherë të tre kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Koli Bele.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve,

## **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 8, datë 01.04.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, kërkesën ankimore nr. 9, datë 01.04.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike dhe kërkesën ankimore nr.10, datë 02.04.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim “PD-AN”.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 03.04.2021, ora 11:00, nga relatori z. Koli Bele.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

**Elvin LAKO** - **Anëtar**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

